



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.321/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 23.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, me të cilën ka pretenduar se me datë 21.10.2017, në kafiterin “ORA”, e cila gjendet në rrugën “Muharrem Ibrahimimi”, në Gjilan, rreth orës 22:00 nga subjekti politik LVV është zhvilluar një aktivitet me përmbajtje elektorale, në të cilin kanë marrë pjesë deputeti Albin Kurti si dhe kandidati për kryetar të Kuvendit Komunal të Gjilanit, nga radhët e subjektit politik LVV.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik LVV ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 7 par. 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një CD lidhur me rastin në fjalë.

Subjekti politik LVV, në përgjigen në ankesë të datës 22.10.2017, ka theksuar se video inqizimi i cili është bashkangjitur ankesës nuk përbën provë e cila mbështet gjendjen faktike të pretenduar nga parashtruesi i ankesës. Meqënëse kriteri kryesor për ta konsideruar se një shkelje e tillë ka ndodhur, duhet vërtetuar elementi kohor. Andaj, veprimet e tilla nuk përbëjnë shkelje në kuptim të dispozitës së nenit 7 par.1 pika b) dhe nuk mund të konsiderohet si delikt zgjedhor. Andaj LVV ka propozuar që ankesa nga subjekti politik LDK të refuzohet si e pa bazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik LVV, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara në ligj të cilat i refuzoj si të pa bazuara, sepse nga video-CD që gjendet në shkresat e lëndës, nuk mund të vërtetohet data dhe ora e shkeljes së pretenduar, që është element esencial për përcaktimin e periudhës kohore të thyerjes së heshtjes zgjedhore, siç përcaktohet me nenin 5 par.7 pika b) e Rregullës Nr. 02/2015 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Nga arsyet e theksuar më lartë e duke bazuar nenin 115, 117 dhe neni 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL. Anr.321/2017 më datën 23.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevc



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.